



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Engineering RK" Sh.P.K. të datës 27.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-7860-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Engineering RK" Sh.P.K. të datës 27.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-7860-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Engineering RK" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Engineering RK" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-7860-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:**

**Pretendimi i parë (I)** - "Duke qene se ky aktivitet i prokurimit eshte vleresuar tek pas 90 diteve AK ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave ,vazhdimin e fundit e kemi bere vetem konzorciumi yne edhe Haxha com Company Sipas dokumenteve qe kemi pasur qasje ne ky Opertaor Ekonomik ka vazhduar sigurimin e tenderit me date 20/22/2023 ora 08:43:25 ,ndersa sigurimi i vjeter ka qene valid deri me date 21/11/2023 ora 08:38:07 çka nenkupton qe per nje interval kohor kjo kompani ka qene pa sigurim te tenderit,dhe duke ditur faktin qe njoftimi per vazhdim te sigurimit,na ka jep kohë te njaftueshme per ta vazhduar ,por ky Operator ka deshtuar ta permblush sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Kosoves dhe Oferta e tij ka qene dashte te refuzohet si e papergjegjslme sepse ka munguar sigurimi i ofertes".

**Pretendimi i dytë (II)** - "Ne baze te dokumenteve te prezentuara kjo kompani ka kryer vleresimin e rrisht tek kompanija NTSH" Tren Cmsh" me seli ne Ferizaj .Sipas vertetimit te leshuar nga kjo kompani te dates 05.09.2022 rezulton qe konforme marreveshjes qe kane pasur keto dy biznese per kryerjen e ketij sherbimi ,palet jane marre vesh per kryerjen e vleresimit te rrisht,dhe ky vleresim ka perfunduar me date 04.02.2021.Ne baze te rregullores 02/2021 per vleresimin e rrisht neni 15 i rregullores pika 1 : Qarte tregon qe vleresimi i rrisht duhet te rishikohet ne qdo dy vjete ,qka nenkupton qe vleresimi i rrisht nga Haxha Com Company nga data 04.02.2023 nuk ka validitet ,pra ketij dokumenti i ka kaluar validiteti".

**Pretendimi i tretë (III)** - "Tek makinerija tek pika 3 eshte kerkuar 2 Eskavator me tonazhe fikse as me te vogel as me te medhenje se 15 T . Ne dokumentet e leshuara nga kjo kompani prezentohet Eskavatorii i tipit TAKEUCHI TB 1140 me tonazhe 15 T,ndersa nga dudi doganor dhe te dhenat teknike shihet se tonazhi eshte 15.1 T ,pra me qellim te pershtatjes se ketij kriteri ka qite ne lajthitje AK,dhe ka deshtuar ta permblush kete kriter Edhe tjetri Eskavator I prezentuar nuk ka peshe fikse 15 T >por me te madhe 15.1T > 15 T,sepse kriteri ka qene 2 Eskavator nga 15 T ,qe asnjerin ky Operator nuk e ka permblushur dhe ata qe I ka prezentuar nuk jane valid dhe ne harmoni me kerkesat e FDT".

**Pretendimi i katërt (IV)** - "OE HAXHA COM -njerin grejder e ka konforme kerkeses,ndersa per grejderin e tipit OK TIP F 106.5 nuk ka prezentuar fakte se i njejt eshte ne pronesi te tij apo e ka marre ne shfrytezimi per kete Aktivitet te Prokurimit.Nga dokumentacioni I prezentuar shihet qe ky grejder ne baze te te dhenave nga dudi doganor eshte ne pronesi te KIMI SHPK me seli ne Obiliq dhe nuk ka kontrate shitblerje edhe as transakcion bankar per kete njet pune.Per kete grejder ka nje fature me te dhenat e ketij grejderi qe Haxha Com ne cilesin e shitesit e shet kete njet ,por nga te dhenat e fatures blesesi eshte Enigmatik,prandaj ky Operator ka deshtuar edhe kete pike ta permblush konforme kerkesave te AK".

**Pretendimi i pestë (V)** - "Pika 9 sipas FDT : eshte kerkuar 6 kamion me kapacitet mbi 20 m3 OE Haxha Com -ka prezentuar kete dokumentacion : 5.1 Kamion me tabela : 02-719-EM me kapacitet 15.6 m3 me e vogel se 20 m3 :1 5.6< 20 m3 4/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK 5.2 Kamion me tabela : 02-732-EM me kapacitet 17.16 m3 me e vogel se 20 m3 :17.16< 20 m3 5.3 Kamion me tabela : 02-735-EM me kapacitet 17.16 m3 me e vogel se 20 m3 :17.16< 20 m3 5.4 Kamion me tabela : 02-736-EM me kapacitet 17.16 m3 me e vogel se 20 m3 :17.16< 20 m3 5.5 Kamion me tabela : 02-737-EM me kapacitet 15.6 m3 me e vogel se 20 m3 : 15.6< 20 m3 Nga te dhenat e mesiperme po shihet se nga 6 kamionet e prezentuar vetem njeri ploteson kriterin nga pika 9 ndersa 5 kamionet e tjere nuk jane ne perputhje me kerkesat e AK ,dhe si perfundim rezulton qe edhe kete pike ka deshtuar ta permblush ky OE".

Sa i përket pretendimeve ankimore, fillimisht duhet sqaruar se nga raporti i komisionit vlerësues është gjetur se parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim GOE "Gashi ING Sh.P.K. & Engineering RK Sh.P.K" janë eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si tenderues të papërgjegjshëm. Arsyet për eliminimin e parashtruesi konsistojnë në faktin se nuk është dorëzuar dëshmia apo marrëveshja si dhe licenca sipas kërkesës së AK "Operatori duhet të posedojë gurëthues ose të ketë marrëveshje për furnizim me gurë të thyer me ndonjë kompani që posedon gurëthyes" si dhe "Lista e prezantuar e pajisjeve dhe dëshmive - mungon dëshmia 2) Eskavator me peshë minimum 34 t- 1 copë si dhe 6) Lugë ngarkuese me peshë minimum 15 t- 1 copë". Fakti se parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nuk kontestohet as nga vet parashtruesi askund në kërkesën e tij për rishqyrtim (pra ky fakt është i pakontestueshëm tanimë). Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP është përcaktuar se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Duke marrë parasysh se nuk është kontestues fakti që parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, kjo nënkupton që i njëjti në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të dëshmojë asnjë rezultat apo rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar. Rrjedhimisht në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP sikurse është cituar më sipër, parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me këtë aktivitet të prokurimit dhe kërkesën e tij për rishqyrtim. Nga ky kënd i vështrimit duhet shtuar që përmes nenit 108/A par. 1 të ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe nenit 59 par. 1 të RRPP është përcaktuar se vetëm palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim. Duke marrë parasysh që parashtruesi nuk e ka statusin e palës së interesuar, nuk e posedon as mundësinë për të parashtruar këtë kërkesë për rishqyrtim. Në këtë mënyrë është konstatuar se kërkesa juaj për rishqyrtim është e palejuar dhe duhet refuzuar në kuptim të nenit 62 par. 62.1 nënpar. b) të RRPP.

Përveç faktit se parashtruesi nuk është palë e interesuar sikurse është sqaruar më sipër, njëkohësisht edhe pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara dhe nuk janë mbështetur në prova ose argumente të qëndrueshme.

Sa i përket pretendimit të parë, as vet parashtruesi nuk e konteston që validiteti ka skaduar me datë 20 nëntor dhe është vazhduar me datë 21 nëntor. Nga raporti i komisionit vlerësues dhe administrimi i dokumenteve të tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar e ka vazhduar validitetin në mënyrë të rregullt sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë, kërkesa nr. 6 të kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të cilës i referohet ky pretendim është formuluar sikurse në vijim:

6.Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë	6.Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.
--	---

Nga raporti i komisionit vlerësues dhe administrimi i dokumenteve të tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar raportin e vlerësimit të riskut në vendet e punës si dhe kopja e licensës së kompanisë së licensuar. Përndryshe nëse analizohet me kujdes pretendimi ankimor, mund të vërehet se as vet parashtruesi nuk e konteston faktin se tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar raportin e vlerësimit të riskut si dhe kopjen e licensës së kompanisë së licensuar. Pra sipas dosjes së tenderit, janë dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe është plotësuar kërkesa në fjalë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit të tretë, të katërt dhe të pestë, ku parashtruesi i konteston pajisjet me të cilat ka ofertuar, Nga raporti i komisionit vlerësues dhe administrimi i dokumenteve të tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar i posedon të gjitha makineritë e kërkuara dhe dokumentet përkatëse sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit. Ky fakt është konfirmuar dhe është rikonfirmuar nga komisioni vlerësues dhe administrimin e ofertës së tenderuesit të rekomanduar. Prandaj edhe këto pretendime janë të pabazuara në tërësi.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 59 paragrafin 59.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.11.2023

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shtetëror të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.